



Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Komuna-Municipality
Hani i Elezit



04/1716 /2025

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORTI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE PËR MUAJIN JANAR 2025

Hani i Elezit, 2025

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për muajin Janar 2025, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësiwe ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësiwe, ka funksionuar kryesisht në katër (4) sektorë:

1. Sektori për buxhet
2. Sektori për financa,
3. Sektori për të hyra dhe
4. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (7) zyrtarëve, gjatë muajit Janar 2025 kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me **NR. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025** është në lartësi prej **3,615,457.00 Euro**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa..... 2,188,542.00 €,
- Mallra dhe shërbime..... 584,500.00 €,
- Shpenzimet komunale94,000.00 €,
- Subvencione dhe transfere ...143,000.00 €,
- Shpenzime kapitale 605,415.00 €,
- Totali i buxhetit..... 3,615,457.00 €.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë këtij muaji, mund t'i veçojmë këto:

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Përgatitja e Raportit Fincanciar për vitin 2024 dhe e kemi dërguar për diskutim në KPF dhe Kuvend Komunal,
- Deklarimi në Thesar obligimet e pa paguara dhe ato kontraktuale për muajin Dhjetor 2024,
- Barazimi me Thesar për vitin 2024,
- Plotësimi i të dhënave përkatëse të Drejtorisë Buxhet dhe Financa në Raportin e Agjendës Evropiane,
- Përgatitja dhe dorëzimi i Raportit të Monitorimit sipas Periudhave (Q4) në Departamentin e Buxhetit – MFPT,
- Hartimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2024 dhe anekset përcjellëse si dhe dorëzimi i tyre në Departamentin e Thesarit – MFPT,
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të Kuvendit, të Sektorit të Arsimit dhe Sektorit të Kujdesit Primar Shëndetësor.

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR MUAJIN JANAR 2025

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Buxheti 2025	Realizimi janar 2025	% Realizim/planifikim
Paga dhe shtesa	2,188,542.00	187,616.32	8.5%
Mallra dhe shërbime	584,500.00	0	0%
Shpenzime komunale	94,000.00	0	0%
Subvencione dhe trans.	143,000.00	0	0%
Shpenzime kapitale	605,415.00	0	0%
TOTAL	3,615,457.00	187,616.32	5.1%

SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2025 është në shumë prej 339,719.00 €. Për shkak të vonesave në marrjen e qasjeve në SIMFK, të hyrat e inkasuara përgjatë muajit janar 2025 janë regjistruar në mënyrë manuale dhe figurojnë si të hyra përgjatë muajit vijues.

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë këtij muaji, ky sektor ka kryer vetëm shërbime të rregullta ndaj qytetarëve, siç janë: lëshimin e faturave të tatimit në pronë, lëshimin e vërtetimeve për qëllime të ndryshme.

Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

L. Ballazhi

